



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr 203 , Datë 12.12.2019

MBI

**MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR MONITORIMIN E TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 ; nenit 22, nenit 51 pika 2 gërma “dh” dhe nenit 97 pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; VKM-së, nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.114/13 Prot, datë 10.12.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Monitorit të Tregut, mbi “Miratimin e rregullave për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”

Konstatohet se:

- Me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 07.03.2019, kanë filluar procedurat për miratimin e “Udhëzuesit për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”.
- Në shkresën nr. 32/9, datë 13.03.2019, ERE bëri publikimin në median e shkruar të Vendimit të bordit të ERE-s nr. 40, datë 07.03.2019, me qëllim mbledhjen e opinionëve të personave ose palëve të interesuara. Në përfundim rezultoi se, asnjë palë e interesuar nuk ka paraqitur opinion në lidhje me këtë draft- udhëzues.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 225, datë 15.03.2019, ERE dërgoi për të marrë mendimin dhe opinionet e Ministrisë së Infrastrukturë dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, shoqërisë OST sh.a., shoqërisë KESH sh.a., shoqërisë OSHEE sh.a., si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Në përfundim të afatit 15 ditor që u ishte kërkuar palëve për paraqitjen e mendimeve, shoqëria “KESH”sha, nëpërmjet shkresës nr. 1465/1, datë 01.04.2019, është shprehur se është dakort me këtë draft-udhëzues të propozuar për monitorimin e tregut të energjisë elektrike.
- Shoqëria “OST” sh.a. me shkresën nr. 2094/1, datë 25.03.2019, ka shprehur opinionin e saj si vijon:
 - Në Tabelën 5-1 të draftit të shtohet përmbajtja pikave “ç” dhe “d” të nenit 20 të Ligjit 43/2015, mbi të drejtat e ERE.
 - Në pikën 9.1 të draftit, përcaktohen aktorët kryesorë të përfshirë në Monitorimin e Tregut, sugjerojmë të shtohet edhe aktori i tretë , Operatori i tregut të organizuar “Bursa Shqiptare e Energjisë(BSHE)”, referuar po ashtu edhe pikës 2.1.11 të Rregullave të Tregut Shqiptar të

Energjisë Elektrike.

- Ndryshimet e propozuara nga shoqëria “OST” sh.a, pranoen pasi nuk bien ndesh me ligjin ose akte të tjera nënligjore dhe japin detaje plotësuese për këtë draft-udhëzues.
- Tregu i energjisë elektrike në vendin tonë është në proces të vazhdueshëm zhvillimi dhe transformimi. Ky zhvillim përfshin hapjen graduale të tregut të energjisë elektrike në vendin tonë, decentralizimin e kompanive të mëdha publike, si dhe krijimin, funksionimin e bursës shqiptare të energjisë.
- Udhëzuesi i monitorimit të tregut të energjisë elektrike përcakton një set parimesh dhe udhëzimesh të përgjithshme të cilat ndihmojnë në realizimin e monitrit të tregut të energjisë elektrike, por që janë të pa mjaftueshme për të ndjekur zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike në vendin tonë në vitet në vijim.
- Numri i pjestarëve të tregut do të vijë duke u rritur dhe monitorimi i këtyre pjestarëve të tregut do të jetë një detyrë parësore e ERE-s me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore të pjestarëve të tregut të energjisë elektrike në terësi si edhe të vetë ERE-s në veçanti.
- Rregullat e monitorimit të energjisë elektrike përcaktojnë në mënyrë të detajuar mënyrën dhe procedurat që do të ndiqen nga ERE për monitorimin e funksionimit të Tregut të Energjisë Elektrike si dhe veprimtari të caktuara të Operatorëve të Transmetimit dhe të Shpërndarjes në funksion të tregut të Energjisë Elektrike në Republikën e Shqipërisë.
- Këto rregulla do t'i mundësojnë ERE që nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të funksionimit të tregut të energjisë elektrike të synojë rritjen efiçenës, konkurrencës dhe transparencës së tregut të energjisë elektrike si dhe identifikimin e parregullsive apo mangësive në këtë treg.
- Këto rregulla do t'i mundësojnë pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që të kenë një informacion me të saktë lidhur me çështjet dhe mënyrën se si do të realizohet procesi i monitorimit të tregut të energjisë elektrike. Miratimi i këtyre rregullave është një garanci e shtuar për pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike të cilat garantojnë trajtimin në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese të pjestarëve të tregut të energjisë elektrike përgjatë procesit të monitorimit të tregut të energjisë elektrike.

Në mënyrë të veçantë rregullat e monitorimit do të realizojnë një proces monitorimi më të detajuar lidhur me:

- zbatimin e detyrimeve ligjore të mbajtësve të licencave në lidhje me mirëfunksionimin e aktiviteteve të rregulluar në fushën e energjisë elektrike të gjithë pjesëmarrësve në treg, duke mos cënuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike;
- mirëfunksionimin e tregjeve të energjisë me qëllim përmirësimin e tyre në lidhje me mosdiskriminimin, konkurrencën, transparencën dhe efikasitetin e tyre;
- zbatimin e rregullave për menaxhimin e kapaciteteve të interkonjeksionit; menaxhimin e mbingarkesës në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në zbatim të detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi;

- përdorimin e të ardhurave për mirë menaxhimin e kongjestionëve në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike;
- dhënien e kohës së nevojshme të operatorëve të sistemeve përkatëse për riparimin e ndërprerjeve/defekteve apo remonteve të planifikuara;
- publikimin në kohë të informacionit të duhur nga operatorët e sistemeve, në mënyrë që ti mundësohet palëve të interesuara për përdorimin e linjave të interkonjeksionit apo rrjeteve të sistemit elektroenergjitik si dhe ndarjen e kapaciteteve ndërkufitare, të marrin masat përkatëse;
- ndryshimin në strukturën e pronësisë së të licencuarve që kryerjnë aktivitete në fushën e energjisë duke propozuar veprimet e nevojshme që institucionet kompetente shtetërore duhet të kryejnë për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës në tregjet e energjisë;
- aplikimin e sistemeve tarifore dhe tarifave të përcaktuara;
- aplikimin e termave të ndryshme si dhe kostot respektive për lidhjen e kapaciteteve të reja gjeneruese duke marrë në konsideratë kosto përfitimet e teknologjive të ndryshme në fushën e energjive të rinovueshme, duke trajtuar prodhimin e energjisë termale dhe energjisë elektrike si veç e veç, ashtu edhe së bashku;
- përputhshmërinë e veprimeve të mbajtësve së licencave që operojnë në fushën e energjisë, në lidhje me zbatimin e detyrimeve (kushteve) të licencës;
- cilësinë e shërbimeve të ofruara nga mbajtësit e licencave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e energjisë;
- ndarjen reale të llogarive, siç përcakton ligji, me qëllim shmangien e ndërsubvencionimit ndërmjet grupeve të konsumatorëve si dhe tejkalimi i të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kryerjes së aktiviteteve në fushën e energjisë, qofshin këto të rregulluara ose jo;
- zbatimin e programeve të tilla që u sigurojnë operatorëve të sistemeve përkatëse pavarësi të plotë ligjore, financiare, menaxheriale dhe funksionale për Shoqëritë, duke bërë të mundur mosdiskriminimin, transparencën dhe konkurrencën në funksionimin e tregjeve të energjisë.
- Rregullat e monitorimit të tregut të energjisë elektrike do të përcaktojnë në anekset e tyre formate të sakta për informacionin që do të dorëzojnë në ERE pjesmarrësit në tregun e energjisë elektrike. Standartizimi i formateve të dërgimit të informacionit dhe përcaktimi i afateve për dorëzimin e informacionit dhe të dhënave përveç se i vë në kushte të barabarta të gjithë pjesmarrësit e tregut të energjisë elektrike mundëson përpunimin dhe analizën më të mirë të çdo të dhënë të paraqitur nga këta pjesmarrës tregu në ERE.
- Rregullat e monitorimit garantojnë ruajtjen e kofidencialitetit të dhënave dhe informacioneve të kërkuara, nga të licencuarit që operojnë në tregun e energjisë të cilat konsiderohen si të tilla. Trajtimi dhe përdorimi i këtyre informacioneve do të bëhet do të bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e “Rregullave për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”. (Bashkëlidhur)
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 01.01.2020

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

RREGULLAT PËR MONITORIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Kapitulli I Dispozita të Përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

1. Rregullat për Monitorimin e Tregut të Energjisë Elektrike (më poshtë referuar si "Rregullat") përcaktojnë mënyrën dhe procedurat për monitorimin e funksionimit të Tregut të Energjisë Elektrike si dhe veprimtari të caktuara të Operatorëve të Transmetimit dhe të Shpërndarjes për funksionimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Republikën e Shqipërisë.
2. Monitorimi i funksionimit të tregut të energjisë elektrike realizohet nga Enti Rregullator i Energjisë (më poshtë referuar si "ERE").
3. Monitorimi dhe kontrolli i funksionimit të tregut të energjisë elektrike ka për qëllim rritjen e efikasitetit, konkurrencës dhe transparencës së tregut të energjisë elektrike si dhe identifikimin e parregullsive si me poshte:
 - i. Shmangien nga parimet e konkurrencës të pjestareve të tregut të energjisë elektrike,
 - ii. Realizimin e praktikave të parregullta tregtare të cilat cenojnë mirë funksionimin e tregut, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe detyrimet e tjera të specifikuar në kushtet e licencave për kryerjen e veprimtarive në Sektorin e Energjisë Elektrike.
4. Nëse gjatë monitorimit të funksionimit të tregut të energjisë elektrike konstatohen parregullsi, ERE pasi shqyrton sjelljen e subjektit (eve), në përputhje me Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike si dhe aktet nënligjore përkatëse, merr masat e duhura, në drejtim të sigurisë së furnizimit, efikasitetit, konkurrencës, funksionimit jodiskriminues të tregut të energjisë elektrike si dhe mbrojtjes së të drejtave të klientëve dhe përdoruesve të tjerë të rrjetit.
5. Gjatë kryerjes së veprimtarive sipas paragrafit (4), ERE mund të bashkëpunojë me institucione të tjera, me Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë si dhe me Sekretariatit e Komuniteti i energjisë.

Neni 2 Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë Rregullore do të përkufizohen si më poshtë:
 - a) **“Tregu i energjisë elektrike”** – është një sistem ku kryhen transaksione të shitjeve dhe blerje efektive të energjisë elektrike, përfshirë edhe derivate që lidhen me këto treg.
 - b) **“Tregu me shumicë i energjisë elektrike”** – kemi parasysh tregun për shit-blerjen e energjisë elektrike të prodhuar në Republikën e Shqipërisë, energjinë e importuar si dhe energji elektrike të blerë për shitje brenda ose jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, ku përfshihen transaksionet e bëra ndërmjet prodhuesve, tregtarëve, furnitorëve si dhe transaksionet ndërmjet tregtarëve dhe klientëve;
 - c) **“Treg të shitjes me pakicë të energjisë elektrike”** – kemi parasysh tregun për shitjen e energjisë elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë, treg në të cilin kryhen edhe transaksionet ndërmjet furnizuesve dhe konsumatorëve;
 - d) **“Tregtimi i energjisë elektrike”** – është procesi që kryhet nga një person juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitjen e saj brenda ose jashtë teritorit të vendit ku kryen veprimtarinë;
 - e) **“Furnizimi i energjisë elektrike”** – është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike të klientët;
 - f) **“Ankesë të klientit”** – shprehja e çdo forme pakënaqësie të klientit, nëpërmjet formave të ndryshme si letër, e-mail, thirrje telefonike apo paraqitja e vetë personit pretendues;
 - g) **“Kërkesë për informacion”** – kemi parasysh kërkesën për informacion ose këshilla (jo ankesë) nga ana e një personi apo subjekti ndaj: një organi përgjegjës për trajtimin e ankesave, një qendër informimi të ofruesit të shërbimit apo ndaj një organizate që asiston në dhënien e këtij lloji informacioni;
 - h) **“Kongjestion”** – rasti kur kapaciteti transmetues ndërkufitar i kërkuar është më i madh se kapaciteti transmetues ndërkufitar i disponueshëm në kufirin dhe drejtimin përkatës;
 - i) **“Furnizues i mundësisë së fundit”** – është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat ligjore, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre;
 - j) **“Operator të sistemit”** – kemi parasysh operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe atë të transmetimit të energjisë elektrike;
 - k) **“Operatori i tregut”** – është subjekti i licencuar nga ERE për organizimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë dhe të tregut brenda së njëjtës ditë.”;
 - l) **“Klient”** – është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale;
 - m) **“Klient fundor”** – është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak;
 - n) **“Klient jofamiljar”** – janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila kjo energji nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës;

- o) **“Klient i vogël jofamiljar”** – është një person fizik apo juridik, i lidhur në nivel tensioni 0,4 kV, i cili blen energji për përdorim në mjediset ku ai ushtron aktivitetin e tij dhe jo për qëllim rishitjeje;
 - p) **“Klient shumice”** – është një person fizik ose juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitje brenda ose jashtë vendit ku është regjistruar për të kryer aktivitetin e vet;
 - q) **“Klient në nevojë”** – është një klient familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar;
 - r) **“Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike”** është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatori i tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.
2. Çdo përkufizim ose term tjetër i përdorur në këtë rregullore, ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

3. Lista e Shkurtimeve të përdorura në këto Rregulla:

SEE - Sistemi i Energjisë Elektrike;

OSSH - Operator i Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike;

OST - Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike;

RES - Burimet e rinovueshme të energjisë;

OT - Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike;

ERE - Enti Rregullator i Energjisë;

SAIDI - Treguesi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve në sistemin e shpërndarjes;

SAIFI - Treguesi i numrit mesatar të ndërprerjeve për konsumator.

Neni 3

Fusha e zbatimit të këtyre Rregullave

1. Monitorimi i funksionimit të tregut të energjisë elektrike ka të bëjë me mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe të informacionit, si dhe publikimin e informacionit në lidhje me:
 - a) zbatimin e detyrimeve ligjore të mbartësve të licencave në lidhje me mirëfunksionimin e aktiviteteve në sektorin e energjisë elektrike të gjithë pjesëmarrësve në treg, duke mos cënuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike;
 - b) mirëfunksionimin e tregjeve të energjisë me qëllim përmirësimin e tyre në lidhje me mosdiskriminimin, konkurrencën, transparencën dhe efikasitetin e tyre;
 - c) zbatimin e rregullave për menaxhimin e kapaciteteve të interkonjeksionit; menaxhimin e mbingarkesës në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike si

dhe në zbatim të detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi;

- d) përdorimin e të ardhurave për mirë menaxhimin e kongjestioneve në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike;
- e) dhënien e kohës së nevojshme të operatorëve të sistemeve përkatëse për riparimin e ndërprerjeve/defekteve apo remonteve të planifikuara;
- f) publikimin në kohë të informacionit të duhur nga operatorët e sistemeve, në mënyrë që ti mundësohet palëve të interesuara për përdorimin e linjave të interkonjeksionit apo rrjeteve të sistemit elektroenergjitik si dhe ndarjen e kapaciteteve ndërkufitare, të marrin masat përkatëse;
- g) ndryshimin në strukturën e pronësisë së të licencuarve që kryerjnë aktivitete në fushën e energjisë duke propozuar veprimet e nevojshme që institucionet kompetente shtetërore duhet të kryejnë për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës në tregjet e energjisë;
- h) aplikimin e sistemeve tarifore dhe tarifave të përcaktuara;
- i) aplikimin e termave të ndryshme si dhe kostot respektive për lidhjen e kapaciteteve të reja gjeneruese duke marrë në konsideratë kosto përfitimet e teknologjive të ndryshme në fushën e energjive të rinovueshme, duke trajtuar prodhimin e energjisë termale dhe energjisë elektrike si veç e veç, ashtu edhe së bashku;
- j) përputhshmërinë e veprimeve të mbajtësve së licencave që operojnë në fushën e energjisë, në lidhje me zbatimin e detyrimeve (kushteve) të licencës;
- k) cilësinë e shërbimeve të ofruara nga mbajtësit e licencave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e energjisë;
- l) ndarjen reale të llogarive, siç përcakton ligji, me qëllim shmangien e ndërsuvencionimit ndërmjet grupeve të konsumatorëve si dhe tejkalimi i të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kryerjes së aktiviteteve në fushën e energjisë, qofshin këto të rregulluara ose jo;
- m) zbatimin e programeve të tilla që u sigurojnë operatorëve të sistemeve përkatëse pavarësi të plotë ligjore, financiare, menaxheriale dhe funksionale për Shoqëritë, duke bërë të mundur mosdiskriminimin, transparencën dhe konkurrencën në funksionimin e tregjeve të energjisë.

Neni 4

Mënyra e zbatimit

1. Të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike janë të detyruar të dorëzojnë në ERE çdo lloj informacioni të përcaktuar në këto Rregullore si dhe çdo informacion tjetër të kerkuar nga ERE, me qëllim monitorimin e funksionimit të tregjeve të energjisë elektrike sipas mënyrës, formës dhe kushteve të përcaktuara në anekset e këtyre Rregullave. Në rastin e percjelljes së informacioneve të cilat konsiderohen si konfidenciale nga ana e pjestareve të tregut, këta të fundit duhet të bëjnë me dije këtë fakt dhe ERE do të trajtojë informacionin në përputhje me legjislacionin në fuqi për ruajtjen e informacionit.

2. Format që përmbajnë të dhënat dhe informacionin e kërkuar në pikën 1 të këtij neni duhet të dorëzohen në formë elektronike nëpërmjet e-mail-it në adresën elektronike dmt@ere.gov.al, në cdo adresë tjetër të kërkuar zyrtarisht nga ERE ose nëpërmjet një platforme të posaçme “online” të ERE-s.
3. Të dhënat dhe informacioni i kërkuar në pikën 1 të këtij neni, si rregull duhet të dorëzohet periodikisht në ERE brenda 30 ditëve nga raportimi paraardhës, ERE ka të drejtë që për disa lloje të dhënash dhe informacioni të aplikohen afate të ndryshme që nuk mund të përcaktohen në këto Rregulla.
4. ERE mund të kërkojë në cdo kohë nga të licencuarit që operojnë në tregun e energjisë informacione dhe të dhëna shtesë.
5. Disa nga të dhënat dhe informacionet e kërkuara, sipas përcaktimeve të këtyre Rregullave nga të licencuarit që operojnë në tregun e energjisë do të konsiderohen konfidenciale, ndërkohë që ruajtja dhe përdorimi i tyre do të bëhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave;
6. ERE, me qëllim sigurimin e monitorimit efektiv të mbarëvajtjes së tregut të energjisë, mundet gjithashtu të mbledhë, përdorë dhe analizojë të dhëna dhe informacione nga burime të tjera, të cilat do të përdoren dhe publikohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe standardet e pranuar ndërkombëtare

Neni 5

Raportet mbi monitorimin e funksionimit të tregjeve të energjisë

1. Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE, së paku tre herë në vit, do të përgatisë dhe publikojë raporte për monitorimin e funksionimit të tregjeve të energjisë.
2. Në raportet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, ERE publikon vetëm të dhëna në lidhje me disa nga treguesit kryesorë. Nëse ndonjë nga treguesit në lidhje me pjesëmarrësit e tregut të parregulluar nuk rakordohet dhe konfirmohet nga të paktën tre burime të pavarura (të licencuar), atëherë ai nuk do të publikohet në raport.

Neni 6

Besueshmëria e informacionit të dorëzuar

1. Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike duhet të caktojnë një person të autorizuar i cili do të jetë përgjegjës për mbajtjen e marrëdhënieve me ERE-n, duke i mundur ERE-s marrjen e informacionit të përcaktuar në këto Rregulla, nëpërmjet komunikimit me e-mail apo platformës “online” të ngritur për këtë qëllim.
2. Procesi, siç është cituar në pikën e mësipërme duhet të përmbajë gjithashtu një deklaratë mbi besueshmërinë e të dhënave të dërguara, deklaratë e cila publikohet në faqen e internetit të ERE-s.
3. Një deklaratë e tillë, plotësohet nga pjesëmarrësit egzistues të tregut të energjisë elektrike pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore dhe dërgohet në ERE në formë elektronike, të licensuarit e rinj plotësojnë këto deklarate përpara datës së hyrjes në fuqi të licencës për kryerjen e një aktiviteti të caktuar në sektorin e energjisë.

4. Çdo ndryshim në lidhje me personin e autorizuar nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë për mbajtjen e marrëdhënieve me ERE-n, i njoftohet kësaj të fundit brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e një ndryshimi të tillë, nëpërmjet dorëzimit të formularit përkatës, sipas termave të përmendur në pikën 2 të këtij neni.
5. Të gjitha të dhënat apo informacionet e dorëzuara nga personi i autorizuar, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni do të konsiderohen si të sakta dhe të besueshme, dhe që reflektojnë në mënyrë të plotë gjendjen aktuale të të licencuarit.
6. pjesëmarrësit e tregut të energjisë do të jenë përgjegjës për garantimin e saktësisë dhe besueshmerisë së informacionit të dërguar në ERE në çdo rast.
7. Çdo ndryshim apo korrigjim i të dhënave tashmë të dërguara nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë sipas pikës 4 të këtij neni, mund të dorëzohen në ERE brenda 15 ditëve nga paraqitja e këtyre të dhënave, të përcaktuara tashmë në pikën 3 të po këtij neni.

Neni 7

Qëllimi i monitorimit të funksionimit të tregut të energjisë elektrike

1. Në mënyrë të veçantë, monitorimi i tregut të energjisë elektrike kryhet për këto arsye:
 - a) organizimin e tregut të energjisë elektrike, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi; dhe
 - b) Mirë funksionimin dhe fitueshmërinë e tregut të energjisë elektrike.
2. Monitorimi i strukturës së tregut të energjisë elektrike, siç përmendur në gërmën a të pikës 1 të këtij neni, bëhet në këto drejtime:
 - a) liberalizimi i tregut të energjisë elektrike; dhe
 - b) arritja e asaj shkalle pavarësie operationale, financiare dhe ligjore që kërkohet nga Ligji, gjatë kryerjes së veprimtarive të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, furnizimit dhe furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike në vendin tone.
3. Monitorimi i efikasitetit të tregut të energjisë elektrike (gërma b e pikës 1 të këtij neni) arrihet duke monitoruar dhe analizuar sjelljet dhe veprimtarinë e pjesëmarrësve në këto drejtime:
 - a) funksionimin e tregut të shitjes me shumicë;
 - b) funksionimin e tregut të shitjes me pakicë;
 - c) lidhjen, aksesin dhe përdorimin e rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë dhe;
 - d) cilësinë e shërbimeve që i ofrohen klientëve.
4. Monitorimi i mbarëvajtjes së tregut të shitjes me shumicë kryhet nëpërmjet monitorimit të gjenerimit, transmetimit, tregtimit dhe importit të energjisë si dhe çmimeve të tregut të shitjes me shumicë.
5. Monitorimi i mbarëvajtjes së tregut të shitjes me pakicë kryhet nëpërmjet monitorimit të çmimeve të shitjes me pakicë dhe lehtësisë me të cilën aplikohen procedurat e ndërrimit të furnizuesit të energjisë.

6. Monitorimi i cilësisë së shërbimeve do të kryhet nëpërmjet monitorimit të vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike, nivelit të tensionit si dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike që reflektohet në aktivitetin e këtyre subjekteve (shërbimeve tregtare).

Kapitulli II

Monitorimi i strukturës së tregut të energjisë elektrike

Neni 8

Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike

1. Te gjithë Pjesëmarrësit në tregun e energjisë (tregtarët, furnizuesit, furnizuesit e mundësisë së fundit, operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë duhet të informojnë periodikisht në lidhje me numrin e klientëve si dhe kategorizimin e tyre sipas percaktimeve të legjislacionit në fuqi

Neni 9

Pavarësia operationale, financiare dhe ligjore e operatorëve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Deri më 28 Shkurt të çdo viti, OST-të dhe OSSH-të duhet të paraqesin informacion për vitin e mëparshëm kalendarik në lidhje me zbatimin e programeve të harmonizimit, në lidhje me pavarësinë e tyre të plotë ligjore, financiare, menaxheriale si dhe funksionale ndaj Shoqërive në të cilat ato janë integruar vertikalisht dhe në mënyrë specifike në veprimtaritë e:
 - a) transmetimit, prodhimit, shpërndarjes, tregtisë, furnizimit dhe furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë;
 - b) sigurimit të shërbimeve publike në mënyrë të tillë që të sigurojë mosdiskriminim, transparencën dhe objektivitetin e funksionimit të tregut të energjisë.

Kapitulli III

Monitorimi i funksionimit të tregut me shumicë të energjisë elektrike

Neni 10

Prodhimi i energjisë elektrike

1. Të licencuarit në fushën e prodhimit të energjisë elektrike duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informacione të nevojshme në lidhje me prodhimin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë:
 - a) kapacitetin e instaluar dhe sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga secili prodhues, përfshirë edhe konsumin vetjak;
 - b) ndërprerjet e planifikuara ose jo të planifikuara të njësive gjeneruese.

2. I licencuari në veprimtarinë e operatorit të tregut të energjisë është i detyruar të paraqesë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me prodhuesit e energjisë që përfitojnë nga “*feed-in tariff*”, si më poshtë:
 - a) Llojin e prodhuesit, numrin unik të regjistrimit, emrin e prodhuesit, sasinë e energjisë dhe pagesat për secilin prodhues që përfiton nga “*feed-in tariff*”; si dhe
 - b) sasinë totale të energjisë së prodhuar nga ata prodhues që përfitojnë “*feed-in tariff*”.

Neni 11

Bilanci energjetik, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike

1. OST duhet të dorëzojë të dhëna në lidhje me importin, transaksionet dhe transmetimin e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit të Republikës së Shqipërisë, përdorimin e linjave të interkonjeksionit dhe procedurat e përdorura për dhënien e kapaciteteve të linjave të interkonjeksionit, duke përfshirë:
 - a) bilancin e energjisë;
 - b) disponueshmërinë e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare dhe zbatimin e procedurave të alokimit të tyre; si dhe
 - c) të dhëna për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare, shuma e të ardhurave dhe çmimet mesatare për çdo kufi.
 - d) Cdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ERE.
2. OSSH-të duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informacione në lidhje me bilancin e energjisë elektrike si dhe cdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ERE.

Neni 12

Çmimet e energjisë elektrike në tregun me shumicë të energjisë elektrike

1. Të licencuarit në veprimtarinë e transmetimit dhe të shpërndarjes, operatorët e tregjeve të energjisë, tregtarët, furnizuesit dhe prodhuesit e energjisë elektrike, duhet të japin të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me ndryshimin e çmimeve të energjisë në tregun e shitjes me shumicë, duke përfshirë:
 - a. çmimet për njësi, çmimet mesatare dhe sasinë të energjisë respektive;
 - b. çmimet për njësi dhe çmimet mesatare të shitjes si dhe sasinë të energjisë elektrike të prodhuara;
 - c. çmimet për njësi dhe çmimet mesatare të shitjes dhe sasinë të energjisë elektrike të furnizuar për çdo grup konsumatorësh;
 - d. çmimet për njësi dhe çmimet mesatare të blerjes dhe sasinë të energjisë elektrike të lëvruara;
 - e. çmimet për njësi dhe çmimet mesatare dhe sasinë të energjisë elektrike të blera për mbulimin e humbjeve; si dhe;
 - f. të dhënat për shërbimet ndihmëse të lëvruara me marrëveshjet e rregulluara apo të blera në treg;
 - g. disbalancat e ndara sipas grupeve përgjegjëse – balancuese;
 - h. tarifatat e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike.

2. Çdo 6 muaj, të licencuarit në aktivitet e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, dorëzojnë të dhënat në lidhje me tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike.
3. Çdo 6 muaj, tregtarët, furnizuesit, mundësisë së fundit si dhe furnizuesit e klientëve tariforë dorëzojnë të dhëna në lidhje me çmimet per njesi dhe cmimet mesatare mesatare të shitjes dhe sasitë e energjisë elektrike të lëvruar për çdo grup klientësh.

Kapitulli IV

Monitorimi i funksionimit të tregut me pakicë të energjisë elektrike

Neni 13

Çmimet e energjisë elektrike në tregun e shitjes me pakicë të energjisë elektrike

1. Tregtarët, furnizuesit, mundësisë së fundit si dhe furnizuesit e klientëve tariforë duhet të dërgojnë të dhëna dhe informacion në lidhje me çmimet mesatare të shitjes me pakicë, çmimet për klientët tariforë si dhe ata të furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Neni 14

Ndryshimi i furnizuesit

1. OST-të dhe OSSH-të duhet të japin të dhënat dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat për ndryshimin e furnizuesit, duke përfshirë të dhëna dhe informacion në lidhje me numrin e kërkesave të paraqitura për këtë qëllim, ndryshimet e furnizuesve për çdo grup klientësh si respektimi i afateve të përcaktuara për këto lloj procedurash.
2. OST-të duhet të dërgojnë të dhënat e sipërpërmendura mbi baza vjetore.

Kapitulli V

Monitorimi i kushteve për lidhjen, aksesin dhe mënyrën e përdorimit të rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike

Neni 15

Lidhja me një rrjet

1. OST-të dhe OSSH-të duhet të japin të dhëna dhe informacione të nevojshme për sa i përket lidhjeve në rrjet, si më poshtë:
 - a) numrin e aplikimeve të marra, ato të miratuara dhe të zbatuara sipas grupeve të klientëve dhe nivelin e tensionit në të cilin ata janë lidhur;
 - b) numrin e klientëve të shkyçur dhe arsyet përkatëse;
 - c) OSSH i raporton këto të dhënave (numrin e lidhjeve sipas nivelit të tensionit apo grupeve të klientëve si dhe numrin e klientëve të shkyçur), mbi baza mujore;
 - d) OST i raporton këto të dhënave (numrin e lidhjeve sipas nivelit të tensionit si dhe numrin e klientëve të shkyçur), mbi baza 3 (tre) mujore.

- e) OST dhe OSHEE duhet të japin të dhëna lidhur me respektimin e afateve kohore për lidhjen e përdoruesve në rrjetet respektive.

Neni 16

Aksesi në një rrjet

1. OST-të dhe OSSH-të duhet të paraqesin të dhëna dhe informacione në lidhje me zbatimin e parimeve dhe kushteve ligjore të aksesit në rrjet të palëve të treta, përfshirë numrin e aplikimeve të marra, ato të aprovuara si dhe ato të refuzuara si dhe kohën e realizimit të procesit nga marja e kërkesës deri në përfundimin e procesit të dhenies së autorizimit.

Kapitulli VI

Monitorimi i cilësisë së shërbimeve

Neni 17

Vazhdimësia e furnizimit

2. OSSH-të duhet të paraqesin të dhënat dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me vazhdimësinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë:
 - a) numrin e ndërprerjeve të planifikuara dhe të paplanifikuara sipas niveleve të tensionit;
 - b) kohëzgjatjen e ndërprerjeve të planifikuara dhe të paplanifikuara sipas nivelit të tensionit; dhe
 - c) llogaritjen e treguesve që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e furnizimit me energji elektrike (SAIDI, SAIFI).

Neni 18

Cilësia e tensionit

1. OST dhe OSSH duhet të paraqesin të dhënat dhe informacionin e nevojshëm në lidhje me cilësinë e furnizimit me energji elektrike ku përfshihen nivelet e tensionit, për çdo nivel tensioni që operojnë në rrjetet e tyre, ankesat e marra duke përfshirë numrin, llojin dhe kohën mesatare të përgjigjes ndaj tyre që kanë lidhje me cilësinë e furnizimit me energji elektrike ku përfshihen dhe ankesat për ndërprerje të furnizimit me energji elektrike.

Neni 19

Cilësia e rrjetit dhe e shërbimeve tregtare

1. Të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit, të furnizuesit të mundësisë së fundit si dhe ata të klientëve tariforë duhet të japin të dhënat

dhe informacionet e nevojshme në lidhje me cilësinë e lëvrimin të shërbimeve tregtare, duke përfshirë:

- a) numrin dhe llojin e ankesave të marra, ato të trajtuara dhe të zgjidhura apo të refuzuara, si dhe kohën mesatare të përgjigjes ndaj tyre;
 - b) numrin dhe llojin e kërkesave për informacionin, të ardhura nga klientët si dhe menyra e trajtimit të këtyre kërkesave;
 - c) komunikimet e bëra me klientët në formën e numrit total të telefonatave, e-mail-ëve, paraqitjeve në qendrat e kujdesit ndaj klientit si dhe kërkesat e mbërritura në formë shkresore nga grupe të ndryshme klientësh (të vegjël, të mëdhenj apo klientë familjarë).
2. Me kërkesë të ERE-s, të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit, të furnizuesit të mundësisë së fundit si dhe ata të klientëve tariforë duhet të japin të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me:
- a) publikimin e informacionit mbi përdoruesit e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes në lidhje me aksesin në rrjet;
 - b) publikimin e informacionit në lidhje me kontratat tip me furnizuesit, ndryshimet e termave të kontratës, mënyrat e pagesës, çmimet, procedurat për ndryshimin e furnizuesit si dhe aksesin në qendrat e kujdesit ndaj klientit;
 - c) OST raportin mbi baza vjetore në lidhje me numrin dhe llojin e ankesave të marra, të aprovuara apo refuzuara.

Neni 20

Dispozitat kalimtare

1. Detyrimi për të raportuar, dërguar të dhëna apo informacione, siç përcaktuar në këto Rregulla fillon me hyrjen në fuqi të këtyre Rregullave dhe do të aplikohet për të dhënat e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike duke filluar nga data 1 Janar 2020 sipas formave të përcaktuara në Aneksin A dhe nga data 1 Korrik 2020 sipas formave të përcaktuara në Aneksin B të këtyre Rregullave .

Neni 21

Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, Vendimi i Bordit të ERE-s me nr. 42, datë 01.10.2004 shfuqizohet.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi në datë 01.01.2020